



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Fier, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Data 23.08.2022**

Drejtuar: OE: **PEGASUS. sh.p.k** me Nipt **J62903750A**, Adresa: **Tiranë, Rruga “Siri Kodra”, tek ish frigoriferi, nr. 149.**

Procedura e prokurimit/lotit: – Procedure e Hapur – Mallra – Prokurim me mjete elektronike” - Marrëveshje Kuadër me nje operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-36940-07-22-2022**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Kite dhe Reagentë për nevoja spitalore”** – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: **nr. 106 datë 01.08.2022.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. PEGASUS. sh.p.k**

**J62903750A**

- Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
- Vlera **26 494 720 (njëzet e gjashtë million e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzet)** lekë pa tvsh (me numra dhe fjalë)

**2. CFO PHARMA sh.p.k**

**K22305002U**

- Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
- Vlera **26 999 999 (njëzet e gjashtë million e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë )** lekë pa tvsh. (me numra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

**1. CFO PHARMA sh.p.k me NIPT K22305002U**

***Konkretisht për arsyet e mëposhtme:***

**1.CFO PHARMA sh.p.k**

1. Nuk ploteson kriterin e vecante të vendosur në dokumentat standarde të tenderit konkretisht : në pikën 2 të “Kritereve të vecanta të kualifikimit”, konkretisht pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar (Dokumentat duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara).
2. Nuk plotëson kriterin e vecante, konkretisht pika 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomike pika a “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë certifikatën ISO 9001”2015 mbi “Sistemët e menaxhimit të cilësisë”me objekt aktiviteti të certifikatës për tregëtimin të materialeve mjekësore ose ekuivalent në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ I vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose nga organizma nderkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Autorizimet nga prodhuesit për tregëtimin e artikujve përkatës si dhe certifikat ISO 9001:2015 figurojnë vetëm në gjuhën anglaze , të papërkthyer dhe të panoterizuara .

Sipas legjislacionit për prokurimin publik , nëse gjuha e përdorur në një procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqerohen nga një përkthim i noterizuar në shqip. Ky detyrim ligjor është reflektuar dhe në formularin e kritereve të përgjithshme të kualifikimit shtojca 7.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE: **PEGASUS. sh.p.k me Nipt J62903750A, Adresa: Tiranë, Rruga “Siri Kodra”, tek ish frigoriferi, nr. 149, me vlerë 26 494 720 (njëzet e gjashtë million e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Rudina Degjoni**

